

VENDIM
Nr.100, datë 20.2.2004

PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TË SISTEMIT TË INTEGRUAR TË VËZHGIMIT
KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e studimit të sistemit të integruar të vëzhgimit kombëtar, të hartuar nga grupi ndërministror, në zbatim të urdhrit nr.88, datë 19.6.2003 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit të punës për studimin e mundësisë së ndërtimit të sistemit të integruar të vëzhgimit kombëtar (SIVK)”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Shërbimi Informativ Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Fatos Nano